



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË
V E N D I M

Nr. 165 dt.22.11.1995

MBI
DHENIEN E NDIHMES EKONOMIKE DHE PERFITIMIN E
PAAFTESISE PER MUAJIN GUSHT 1995

Në zbatim të ligjit Nr.7710, dt.18.05.1993 “Për ndihmën ekonomike dhe përkujdesjen shoqërore”, ligjit Nr.7886, dt.08.12.1994 “Për disa ndryshime në ligjin Nr.7710, dt.18.05.1993”, VKM Nr.453, 26.09.1994 “Për dhënie e ndihmës ekonomike”, VKM Nr.311, dt.11.07.1994, “Për përfitimin e paaftësisë”, Këshilli Bashkiak , i mbledhur sot me dt.22.11.1995, pasi shqyrtoi dhe relacionin e Seksionit të Ndihmës Ekonomike dhe të Mbrojtjes Shoqërore,

VENDOSI

1. Miratohet masa e ndihmës ekonomike të plotë për çdo familje sipas relacionit.
2. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **12.665 familje** gjithsej me një fond prej **31.169 milion lekë**, sipas dokumentacionit të përgatitur nga njësitë administrative.
3. Të rifuten në skemën e ndihmës ekonomike :
 - Ilir Piperi, familje me 4 antarë, Nj.A.1
 - Vladimir Zoga, familje me 5 antarë, Nj.A.3

- Violeta Hane, familje me 3 antarë, Nj.A.11
4. Të përfitojnë ndihmë ekonomike si rast i veçantë :
 - Kristina Gjipali, familje me 1 antarë, Nj.A.1
 - Afërdita Kadiu, familje me 1 antarë, Nj.A.3
 5. Pembe Shyti, familje me 1 antarë, ti ndërrohet motivacioni i trajtimit me ndihmë ekonomike në “Për përkujdesje”.
 6. Të ndërpritet ndihma ekonomike **73 familjeve** sipas pasqyrave të bashkangjitura.
 7. Të përfitojnë ndihmë ekonomike **1022 persona** të paaftë me një fond prej **1.544 mijë lekë**.

KRYETARI

BESNIK PETRELA